



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 124, datë 27.10.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E DHËNIES SË AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E**  
**AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SPONSORIZUESIT**  
**SUBJEKTIT “DULE” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA DURRËS, PËR**  
**RIKONSTRUKSIONIN E QENDRËS SHËNDETËSORE SHKAFANE (KURATEN),**  
**NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKM-së nr. 295, datë 02.05.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Ishëm, të Qarkut të Durrësit”, kërkesës që mban datën 22.09.2022 të Subjektit “DULE” shpk, me anë të së cilës shpreh interesimin për të investuar për rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Kuraten, Njësia Administrative Ishëm, ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Per sponsorizimet”, i ndryshuar, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, sipas relacionit të përgatitur nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e aktmarrëveshjes së financimit, ndërmjet sponsorizuesit subjektit “DULE” shpk dhe përfituesit Bashkia Durrës, për

rikonstruksinin e Qendrës Shëndetësore Kuraten, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës.

2. Ngarkohen Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve dhe Njësia Administrative Ishëm për vijimin e procedurave të mëtejshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

### KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 28.10.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834 prot.  
15

Durrës, më 10 .11 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.124 datë 27.10.2022 "Për miratimin e dhënies së autorizimit për nënshkrimin e akt marëveshjes së financimit ndërmjet sponsorizuesit subjekti "Dule shpk" dhe përfituesit Bashkia Durrës për rikonstruksionin e qendrës shëndetësoreë Shkafane(Kuraten) Njësia Administrative, Bashkia Durrës.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

